

Ky hulumtim mbështetet kryesisht në të dhëna sekondare dhe fokusohet në identifikimin e të gjitha strategjive të miratuara në periudhën kohore 2012-2017 nga të gjitha ministrinë (aktualisht qeveria e Kosovës ka gjithsej 21 ministri, 5 nga të cilat nuk kanë pasur strategji në periudhën e përzgjedhur për vlerësim) dhe Zyra e Kryeministrit.

Hulumtimi ka tri pjesë kryesore:

- Në pjesën e parë, janë identifikuar 52 dokumente strategjike të miratuara gjatë kësaj kohe përmes hulumtimit nga zyra.

D+ bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2012 për Procedurat, Kriteret dhe Metodologjinë për përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre për zbatim ka hartuar matriksën e vlerësimit të këtyre dokumenteve strategjike e cila përmban 14 indikatorë për dokumentet strategjike dhe shtatë (7) indikatorë për Planet e Veprimit.

- Në pjesën e dytë, është analizuar përmbajta e vlerësimeve apo opinionëve të Zyrës për Planifikim Strategjik për secilën nga 52 strategjitë e përzgjedhura dhe është nxjerr një pasqyrim i përgjithshëm i këtyre vlerësimeve.
- Në fund është bërë hulumtim rreth angazhimit të vetë institucioneve bartëse për monitorimin dhe vlerësimin e zbatueshmërisë së strategjive në praktikë.